



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com

1. RAPORT I PËRMBLEDHUR

Vlerësimi i institucionit, kursit/syllabusit dhe mësimdhënësit përbën një mekanizëm të rëndësishëm për monitorimin dhe avancimin e cilësisë në arsim, duke siguruar që Kolegji Dardania i realizon me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Ndryshimet cilësore pozitive të evidentuara pas vlerësimit të fundit për vitin akademik 2024/2025 dëshmojnë zhvillimin e vazhdueshëm dhe progresin pozitiv të institucionit, si dhe të programit të studimeve.

1.1 - Gjetjet për institucionin

- Përbushja e standardeve dhe kërkesave ligjore e akademike;
- Staf akademik dhe administrativ cilësor, profesional dhe me përvojë;
- Integrimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i reformave cilësore në shërbime;
- Infrastrukturë bashkëkohore për zhvillimin e procesit mësimor;
- Infrastrukturë funksionale për studentët, duke përfshirë kampusin, bibliotekën, hapësirat studimore, byfenë dhe ambientet tjera mbështetëse;
- Teknologji standarde e informacionit dhe komunikimit;
- Mbështetja e kërkimit shkencor, inovacionit dhe zhvillimit akademik;
- Shërbim dhe këshillim mbështetës për studentët;
- Mbështetja dhe promovimi i arritjeve dhe sukseseve të studentëve;
- Përdorimi i të dhënave dhe analizës së performancës për zhvillim institucional;
- Transparencë në publikimin dhe vlerësimin e rezultateve akademike;
- Zgjerimi dhe bagatimi i bashkëpunimeve dhe lidhjeve ndërkombëtare;
- Rritja e investimeve në kërkim shkencor, zhvillim dhe inovacion;
- Digjitalizimi i proceseve administrative dhe akademike;
- Bashkëpunim cilësor ndërmjet studentëve, stafit akademik dhe administratës;
- Mjedis i sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues për studentët dhe stafin.

1.2 - Rekomandimet për institucionin

- Të vazhdojë puna në organizimin e aktiviteteve të natyrës kulturore-arsimore me studentë;
- Të organizohen më shumë aktivitete sportive, si: turnire të shahut, gara në mes të studentëve të IAL-ve, etj;
- Të vazhdohet avancimi i cilësisë në procesin mësimor dhe shërbimet studentore;
- Të rritet mbështetja për kërkimin shkencor, projektet inovative dhe publikimet akademike;
- Të forcohen më tej bashkëpunimet ndërkombëtare dhe programet e mobilitetit për studentë dhe staf;
- Të vazhdohet puna në organizimin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional të vazhdueshëm për stafin akademik dhe administrativ;
- Të vazhdojë përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe në aktivitetet institucionale;
- Të zhvillohen programe për orientim në karrierë dhe lidhje më të forta me tregun e punës;
- Të promovohen aktivitetet vullnetare dhe angazhimi i studentëve në komunitet.

2.1 - Gjetjet për lëndën/kursin-syllabusin

- 86.4% e kurseve të obliguara janë të përpiluara drejtë dhe aftësojnë për programin përkatës;
- 76.3% e kurseve me zgjedhje vlerësohen si të dobishme për zhvillimin e aftësive në fushën përkatëse;
- 100% e kurseve janë të planifikuara në përputhje me KEK dhe KK të Kosovës;
- Syllabuset përmbushin të gjitha kërkesat standarde për informimin dhe orientimin e studentit, duke përfshirë përshkrimin e lëndës, rezultatet e pritshme, shpërndarjen e ECTS-kredive, kriteret e vlerësimit, metodologjinë e punës, temat e 15 javëve si dhe literaturën obligative dhe ndihmëse;
- Përmbajtjet e ligjëruara janë të strukturuar në mënyrë sfiduese, interesante dhe atraktive për studentët.

2.2 - Rekomandimet për lëndën/kursin-syllabusin

- 13.4% e syllabuseve me rastin e rishikimit të freskohen me literaturë të burimeve të viteve të fundit për fushën përkatëse;
- 6.3% e syllabuseve me rastin e rishikimit preferohet të ristrukturojnë tabelën për shpërndarjen ECTS krediteve sipas modelit të Bolonjës;

- Në syllabuse të natyrës praktike ku parashihet puna me projekte të vendosen kriteret e vlerësimit.

3.1 - Gjetjet për stafin akademik

- 91.2% e studentëve vlerësojnë se stafi akademik zotëron përgatitjen e nevojshme për të zhvilluar ligjëratat në fushat e tyre përkatëse të ekspertizës. Ky rezultat paraqet një gjetje shumë pozitive, duke reflektuar besimin e lartë të studentëve në kompetencat profesionale të mësimitdhënësve të tyre.
- 90.7% e studentëve vlerësojnë se ligjëruesit zbatojnë strategji mësimitdhënieje të orientuara drejt studentit, duke e vendosur atë në qendër të procesit mësimit. Ky aspekt përbën një faktor thelbësor në rritjen e cilësisë së mësimitdhënies, si dhe në përmirësimin e nivelit të përgatitjes së studentëve.
- 93.2% e përgjigjeve të studentëve tregojnë se stafi akademik demonstroi një qëndrim profesional dhe bashkëpunim miqësor me studentët;
- 90% e stafit akademik vlerësohet se zotëron në mënyrë kompetente kurset që ligjëron, duke dëshmuar përgatitje të mirë profesionale dhe aftësi të përshtatshme;
- Nga vlerësimi i studentëve rezulton se rreth 9.1% e mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve akademikë preferohet të rrisin më tej angazhimin e tyre në veprimtarinë arsimore.

3.2 - Rekomandimet për stafin akademik

- Të organizohen trajnime për mësimitdhënie të avancuar, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave metodologjike të të gjithë stafit akademik në përputhje me qasjet bashkëkohore të mësimitdhënies;
- Të organizohen trajnime shtesë për 9.1% të mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të cilët kanë nevojë për forcim të mëtejshëm të përgatitjes së tyre metodologjike;
- Të organozohen trajnime për mësimitdhënës dhe bashkëpunëtor në metodologjinë e punës për hartimin e projekteve hulumtuese;
- Të nxitet stafi akademik për publikime të punimeve shkencore në revistat kredibile, si kusht për avancimin e tyre në karrierë.

2. REKOMANDIME PERFUNDIMTARE

Rezultatet e vlerësimit dëshmojnë suksesin pozitiv të institucionit, të programeve mësimore/syllabuseve dhe të mësimdhënësve. Duke marrë parasysh se vetëm 0.8% e instrumenteve nuk ishin plotësuar në mënyrë të saktë, kjo reflekton një nivel të lartë të angazhimit dhe përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit.

Pas përpunimit të pyetësorëve, në bazë të rezultateve të nxjerra, rezultojnë rekomandimet në vijim:

- *Stafi akademik duhet të rishikojë syllabuset dhe të përditësojë listat e literaturës, duke përfshirë burime bashkëkohore të viteve të fundit, me qëllim sigurimin e përmbajtjes së përditësuar dhe relevante;*
- *Stafi akademik të rishikojë syllabuset me qëllim të përditësimit të tabelave të ngarkesës së studentit dhe të shpërndarjes së krediteve;*
- *Rekomandohet që mësimdhënësit e lëndëve që përfshijnë komponentet e mësimit praktik të parashohin punën me projekte në syllabuset e tyre, me qëllim rritjen e angazhimit dhe zhvillimin e aftësive praktike të studentëve;*
- *Kolegji “Dardania” duhet të vazhdojë procesin e rregullt të vlerësimit të institucionit, kurseve/syllabuseve dhe mësimdhënësve. Pjesëmarrja e lartë e studentëve në këtë proces, si dhe inkurajimi i tyre për të dhënë mendime, kontribuon në identifikimin e gjendjes reale dhe në planifikimin e aktiviteteve për përmirësimin dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë;*
- *Kolegji “Dardania” duhet të angazhohet më tej në organizimin e aktiviteteve sportive për studentët, si turnire shahu dhe gara ndërmjet studentëve të institucioneve të arsimit të lartë.*

Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie duhet të hartojë agjenda të strukturuar dhe të sigurojë angazhimin e trajnerëve të certifikuar në fushën e mësimdhënies bashkëkohore në institucionet e arsimit të lartë. Në këtë drejtim, rekomandohet zhvillimi i disa programeve, si në vijim:

- *Trajnimi i stafit akademik për aplikimin e teknologjisë në mësimdhënie;*
- *Trajnimi i stafit akademik për mësimdhënie efektive dhe zbatimin e mësimit problemor;*

- *Trajnimi i stafit akademik për përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të studentëve;*
- *Trajnime për dizajnimin e vlerësimit bashkëkohor të studentëve të bazuar në kompetenca;*
- *Zhvillimi i trajnimeve për integrimin e teknologjive digjitale në procesin e mësimdhënies;*
- *Trajnime për përdorimin e sistemeve dhe mjeteve digjitale për detektimin dhe parandalimin e plagjiaturës;*
- *Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të programeve të përsosmërisë në mësimdhënie;*
- *Krijimi i platformave të ndryshme për shkëmbim të përvojave mes trajnerëve dhe pedagogëve të tjerë;*
- *Puna me projekte;*
- *Promovimi i diversitetit kulturor dhe gjuhësor në mësimdhënie;*
- *Sistemi administrativ për mbrojtjen e të dhënave.*

2.1 Plani i implementimit të rekomandimeve

Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie, në bashkëpunim me Zyrën për Sigurimin e Cilësisë, duhet të organizojë së paku tre trajnime në bazë të rekomandimeve të mësipërme:

Plani i organizimit të trajnimeve është si vijon:

Trajnimi I: Aplikimi i teknologjisë në mësimdhënie;

Trajnimi II: Zbatimi i mësimin problemor në mësimdhënie;

Trajnimi III: Integrimi i teknologjisë digjitale në mësimdhënie;

Trajnimi IV: Ecuritë bashkëkohore për shkëmbim të praktikave të mira ndërmjet pedagogëve;

ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË